

REPUBLICA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

PROJEKT-V E N D I M

NR. 2333, Datë 18.02.2, 2021

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR BASHKIAK PËR REHABILITIMIN E RRUGËS SHËNGJIN-BAKS-RRJOLL.**

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" i ndryshuar, në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të fondit pyjor e kullësor publik, ndryshuar me VKM nr 684 datë 02.09.2020 ", në VKM nr. 591, datë 9.10.2018, "Për disa ndryshime në VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor" Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor bashkiak, sipërfaqen pyjore që gjatë matjeve do rezultojë se do preket nga rehabilitimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll me referencë kontrate Nr.EBRD/RLRCP/Ë/2020/2.
2. Për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ngarkohet Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

